

Për:

I nderuar Kryeministër në detyrë z. Albin Kurti,
I nderuar Ministër në detyrë i Financave z. Hekuran Murati,
I nderuar Ministër në detyrë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare z. Andin Hoti,
E nderuara Ministre në detyrë për Drejtësi znj. Donika Gërvalla Schwarz,

Kërkesë: Financimi i qëndrueshëm i shërbimeve sociale

Datë: 30 korrik 2027

Nga: Përfaqësuesit e Kolegjiut të Drejtorëve të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, zyrtarët për barazi gjinore, Qendrat për Punë Sociale (QPS), dhe Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK)

Bazuar në diskutimet e përbashkëta të mbajtura më 23 korrik lidhur me sfidat në ofrimin e shërbimeve sociale dhe qasjes praktike për planifikimin dhe financimin e tyre përmes buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, përmes kësaj letrë, u bëjmë thirrje që të zotohen për ndërmarrjen e veprimeve konkrete për avancimin e shërbimeve sociale. Për të na mundësuar të zbatojmë ligjin edhe standardet për shërbime sociale në fuqi, duke kontribuar në mirëqenien e qytetarëve të Kosovës, kërkojmë përkrahjen tuaj urgjentisht.

Duke vlerësuar faktin që jemi në fazën e përgatitjeve për identifikimin dhe përcaktimin e nevojave buxhetore për Projekt Ligjin e Buxhetit për Vitin 2027, kërkojmë që në kuadër të Grantit të Përgjithshëm:

- **Të rritet buxheti i përgjithshëm tek shërbimet sociale për 3 milion euro shtesë, mbi bazën aktuale**
[Hulumtimet](#) kanë treguar se shërbimet sociale në Kosovë vazhdojnë të përballen me financim të pamjaftueshëm dhe të pabazuar në nevojat reale të qytetarëve. Kjo kufizon kapacitetet e QPS dhe institucioneve të tjera, për të përmbushur përgjegjësitë e tyre ligjore dhe për të menaxhuar në mënyrë cilësore rastet, përfshirë rastet e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore dhe nevojat e qytetarëve për shërbimet sociale e familjare të duhura dhe cilësore.

Kjo kërkesë është bazuar në kornizën ligjore në fuqi, për zbatimin e plotë të:

- Ligjit Nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare,
- Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore,
- Protokollit Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale, dhe
- Udhëzimin Administrativ për përcaktimin e kushteve minimale për themelimin e institucioneve të shërbimeve sociale.

Kërkojmë që Qeveria të rrisë kostot për 3 milion euro shtesë në vit për financimin e shërbimeve sociale për të gjitha komunat gjatë tre viteve të ardhshme, përmes Grantit të Përgjithshëm i dedikuar për Komuna. Kjo shumë duhet t'i shtohet bazës ekzistuese të financimit prej rreth 166 milionë euro sa është aktualisht në 38 Komunat e Kosovës e destinuar për shërbime rezidenciale dhe shërbime sociale, në përputhje me nevojat e komunave për plotësimin e nevojave për shërbime sociale dhe familjare për qytetarët në nevojë.

Financimi shtesë duhet të ndahet në mënyrë të qartë në kategoritë përkatëse buxhetore dhe të sigurojë:

- Punësimin shtesë të pesë (5) profesionistëve të shërbimeve sociale në QPS dhe të rritet **numri i punëtorëve të lejuar** dhe vlera e kategorisë për paga dhe mëditje duke mundësuar kështu punësimin e stafit të ri;
- Numri i nevojshëm i profesionistëve të shërbimeve sociale duhet të përcaktohet përmes një formule të qartë, me indikatorë, e cila merr parasysh numrin e popullsisë, strukturën demografike, numrin dhe kompleksitetin e rasteve, shtrirjen territoriale të komunës dhe nevojat e kategorive të cënueshme;
- Financim të dedikuar për mallra dhe shërbime, përfshirë automjetet, pajisjet, inventarin, lodrat dhe materialet e nevojshme për ofrimin cilësor të shërbimeve;
- Rritjen e financimit në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve për mbështetjen e përfituesve të shërbimeve sociale;
- Sigurimin e financimit për investime kapitale, përfshirë përmirësimin dhe përshtatjen e hapësirave të QPS-ve;
- Rritjen e financimit për shërbimet rezidenciale për personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara;
- Rritjen e financimit për shërbimet emergjente për mbrojtjen e fëmijëve; dhe
- Rritjen e mjeteve për fondin emergjent, me një kod të qartë buxhetor, pranë QPS-ve për mbështetjen e menjëhershme të viktimave të dhunës në familje gjatë periudhës kur ato qëndrojnë në polici ose presin vendosjen në një shërbim të përshtatshëm mbrojtës.

Shpërndarja e financimit shtesë ndërmjet komunave duhet të mbështetet në një formulë të drejtë dhe transparente, duke përfshirë numrin e banorëve, fëmijëve pa kujdes prindëror, personave të moshuar, personave me aftësi të kufizuara, viktimave të dhunës dhe përfituesve të tjerë të shërbimeve sociale. Planifikimi dhe shpenzimi i këtyre mjeteve duhet të bëhet duke zbatuar buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, në mënyrë që financimi t'u përgjigjet nevojave të ndryshme të grave, burrave, vajzave dhe djemve.

Poashtu, kërkojmë nga Qeveria gjegjësisht Ministria e Financave që në vitin 2027 ta përfshijë në Planin Legjislativ ndryshimin dhe plotësimin e [Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal](#), me qëllim krijimin e Grantit Specifik për Shërbime Sociale. Ky grant duhet të bazohet në një formulë të qartë, të drejtë dhe të orientuar nga nevojat, duke garantuar financim të dedikuar, të parashikueshëm dhe të qëndrueshëm për shërbimet sociale. Krijimi i tij do të përbënte zgjidhjen afatgjatë për të parandaluar që shërbimet sociale të vazhdojnë të konkurrojnë me prioritetet e tjera komunale brenda Grantit të Përgjithshëm.

RrGK, bazuar në përvojën e saj mbi 15-vjeçare në financat publike, mund të ofrojë ekspertizë dhe asistencë në përcaktimin e formulës dhe kalkulimin e shpërndarjes së shumës prej tre milionë eurosh ndërmjet komunave.